



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2021

Lënda: Kthim përgjigje

ZNJ. _____

E nderuar,

Në përgjigje të kërkesës suaj të administruar me nr. 13967 prot. datë 18.08.2021, në lidhje me problematikat që ju parashtroni, ju sqarojmë si më poshtë:

1. Sipas "Marrëveshjes së bashkëpunimit "Për strehimin e jetimëve në qytetin e Shkodrës", ndërmjet Ministrisë së zhvillimit Urban dhe Bashkisë së Shkodrës, nr. 2691 prot.datë 07.03.2016, në bazë të së cilës është realizuar rikonstrukcioni i ish konviktit të shkollës "Pyjore" dhe përshtatja e tij në banesa sociale, kategoritë që përfitojnë në këtë program janë ato të jetimëve të dalë nga institucionet rezidenciale dhe që banojnë në banesa të papërshtatshme dhe familje një prindërore në kushte të vështira social ekonomike.

Në zbatim të Vendimit nr. 49 datë 30.10.2020 të këshillit bashkiak "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale me qira pranë Qendrës Komunitare "Për familjen" nr. 6 (pranë ish konviktiti të shkollës Pyjore)" janë akomoduar 16 përfitues ku përfshihen individë dhe familje që i përkasin këtyre kategorive. Tre aplikues të tjerë që i përkasin kategorisë së personave me status të jetimit të cilët nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në marrëveshjen e sipërcituar kanë përfituar nga "Subvencionimi i qirasë" (bonus strehimi).

Pranë banesave sociale me qira tek ish Konviktiti i shkollës Pyjore, është ngritur Qendra Komunitare "Për familjen" nr. 6 që synon fuqizimin social ekonomik të përfituesve në këtë program strehimi me qëllim integrimin e tyre dhe kalimin në një program strehimi tjetër më afatgjatë.

2. Gjatë vitit 2021, Bashkia Shkodër do të zbatojë rikualifikimin e Bulevardit "Zogu i Parë", i cili do të implementohet si projekt pilot në rikonceptimin e korsive të biçikletave në qendrën e qytetit; jo me një korsi me dy kahe, por nganje korsi me kahun përkates për bicikleta (960m secila). Këto korsi do të jenë të mbrojtura, si dhe planifikimi i tyre është i koordinuar me parkimin e automjeteve, parkimet dhe rampat për personat me aftësi të kufizuara lëvizjeje, me stacionet e autobusit dhe me vijat e bardha. Bulevardi do të ridizenjohet për një aksesim me komod nga këmbësorët, pedalesit, autobuzët si dhe automjetet private. Vlera e investimit është në proces përgatitje.

Këtë vit, gjithashtu, me përfundimin e punimeve të By-Passit, qytetit të Shkodrës i shtohen rreth 10 km korsi biçikletash panoramike buzë liqenit (5km një krah dhe 5 krahu tjetër).

3. Në qytetin në Shkodrës ofrohet shërbim urban i plotë.
4. Transporti urban kryhet në dy linja:
Linja: “Qendër – Shkodër – Shirokë – Zogaj – Qendër”
Linja: “Bahçallek – Fermentim – Bahçallek”
Për realizimin e shërbimit urban janë në dispozicion 9 mjete: 2 mjete për linjën e parë dhe 7 mjete për linjën e dytë.
5. Bashkia Shkodër nuk ka buxhet në dispozicion për këtë shërbim. Shërbimi realizohet me operator privat dhe financohet nga operatori.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

KRYETAR

Voltana Ademi